Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	REGJISTRUAR	KALUAN NE VITIN PASARDHËS	PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES	REGJISTRUAR	KALUAN NE VITIN PASARDHËS	PËRQINDJA E STUDENTËVE KALUES	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN	PËRQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN	PËRQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN	PERQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	324	309	95 %	242	241	99%	248	135	54%	40	0	-	79	14	18%
INXHINIERI NDËRTIMI	44	42	96 %	30	30	100%	36	27	75%	-	-	-	-	-	-
INXHINIERI KOMPJUTERIKE	129	120	93%	115	114	99%	122	77	63%	-	-	-	-	-	-
DIND-ARKITEKTURË ³	59	57	97%	47	47	100%	43	0	-	40	0	-	79	14	18%
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	41	40	98%	50	50	100%	47	31	66%	-	-	-	-	-	-
INXHINIERI SOFTUERI	51	50	98%	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	338	311	92 %	388	379	98%	381	258	68%	-	-	-	-	-	-
FINANCË-BANKË	61	60	98%	97	96	99%	102	63	62%	-	-	-	-	-	-
FINANCË-BANKË (SHQIP)	25	23	92%	25	22	88%	30	20	67%	-	-	-	-	-	-
ADMINISTRIM BIZNESI	43	39	91 %	52	51	98%	53	33	62%	-	-	-	-	-	-
EKONOMIKS	39	33	85 %	44	43	98%	38	31	81%	-	-	-	-	-	-

¹Në Universitetin "EPOKA", studentët vlerësohen sipas një sistemi të bazuar në notën maksimale të barazvlefshme me 4.00. Në programet e tre cikleve, në mënyrë që studentët të diplomohen, duhet të kenë arritur në përfundim të studimeve një mesatare të përgjithshme prej më së paku 2.00 nga 4.00. Në të njëjtën kohë, studentët mund të marrin çdo semestër një ngarkesë maksimale prej 45 ECTS. Sistemi i vlerësimit të rezultateve të studentëve tek Universiteti "EPOKA" nuk është i bazuar tek kalimi i vitit, por tek kalimi i lëndëve në bazë semestrale. Për këtë arsye, treguesi më i saktë i kalueshmërisë tek Universiteti "EPOKA" është ai i vitit të fundit të kohëzgjatjes normale të studimeve në programin përkatës të studimit.

² Në vitin e tretë është i paraqitur sistemi 3-vjeçar si edhe sistemi 4-vjeçar, ku përfshihen edhe studentët e prapambetur.

³ DIND në Arkitekturë pas vitit të tretë është lënë e paplotësuar, për arsye se është program i integruar 5-vjeçar.

INFORMATIKË EKONOMIKE	137	126	92%	133	131	98%	106	82	77%	-	-	-	-	-	-
MARKETING NDËRKOMBËT AR DHE MENAXHIM LOGJISTIK	33	30	91 %	37	36	97%	52	29	56%	-	-	-	-	-	-
FAKULTETI I DREJTËSISE DHE I SHKENCAVE SOCIALE	34	28	83 %	26	24	92%	47	12	26%	-	-	-	-	-	-
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNI E NDËRKOMBËT ARE	11	10	91 %	14	14	100%	30	12	40%	-	-	-	-	-	-
DREJTËSI	23	18	78%	12	10	83%	17	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTALI	696	648	93%	656	644	98%	676	405	60%	40	0	-	79	14	18%

CIKLI I DYTË

UNIVERSITETI "EPOKA"			
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN	PËRQINDJA E STUDENTËVE QË DIPLOMOHEN
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	89	36	41%
MSc- ARKITEKTURË	3	0	0%
MP- INXHINIERI KOMPJUTERIKE	8	8	100%
MSc- INXHINIERI KOMPJUTERIKE	36	20	56%
MSc - INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	16	10	91%
MSc- INXHINIERI NDËRTIMI	24	7	63%
MP- INXHINIERI NDËRTIMI	2	1	50%
MP- MENAXHIM RISKU DHE MBROJTJE NDAJ ZJARRIT NË INXHINIERINË E NDËRTIMIT	0	0	0%
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	148	76	51%
MP - FINANCË-BANKË	14	5	36%
MSc - FINANCË-BANKË	65	36	95%
MP - ADMINISTRIM BIZNESI	15	13	55%
MSc - ADMINISTRIM BIZNESI	42	22	52%
MSc – EKONOMIKS	12	0	0%
MP - MENAXHIM BIZNESI: PROFILI MENAXHIM ARSIMI	0	0	0%
FAKULTETI I DREJTËSISE DHE I SHKENCAVE SOCIALE	20	12	60%
MP- SHKENCA POLITIKE DHE MARREDHENIE NDERKOMBETARE	3	2	67%

MSc- SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHENIE NDERKOMBETARE	17	10	59%
TOTALI	257	124	48%

CIKLI I TRETË		
UNIVERSITETI "EPOKA"		
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	REGJISTRUAR	U DIPLOMUAN
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	10	2
PhD-ARKITEKTURË	1	0
PhD-INXHINIERI NDERTIMI	3	1
PhD-INXHINIERI KOMPJUTERIKE	6	1
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	7	1
PHD-EKONOMIKS: PROFILI FINANCË-BANKË	2	0
PHD-EKONOMIKS: PROFILI EKONOMIKS	2	0
PHD-ADMINISTRIM BIZNESI	3	1
FAKULTETI I DREJTËSISE DHE I SHKENCAVE SOCIALE	11	0
PHD-SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBËTARE	11	0
TOTALI	28	3

2. Përqindjen e të punësuarve që kanë përfunduar këtë program studimi, nëse institucioni reklamon se ky program përgatit për një karrierë apo pozicion të caktuar;

Universiteti "EPOKA" i jep prioritet të diplomuarve të tij, duke mbajtur lidhjet me ta edhe pas diplomimit të tyre. Zyra e Karrierës dhe i Studentëve të Diplomuar u jep përparësi të lartë të diplomuarve të universitetit, sepse në këtë rrjet dinamik botëror është kaq i rëndësishëm për të gjithë, dhe ne duam ta forcojmë akoma më shumë këtë rrjet.

Gjatë vitit akademik 2019-2020, janë diplomuar 579 studentë në programet e studimeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë. Për një muaj, Zyra Planifikimit të Karrierës dhe Studentëve të Diplomuar kontaktoi më të gjithë të diplomuarit, me anë të telefonit, Emailit dhe rrjeteve sociale për të marrë të dhëna rreth tyre. Në këtë studim, siguroam të dhëna për 98.7% të diplomuarve në lidhje me punësimin.

Përqindjet e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të punësimit janë të paraqitura si mëposhtë vijon:

Në Administratën Shtetërore	25.7%
Në sektorin privat	52.5%

Janë të vetëpunësuar	4.6%
Vazhdojnë Masterin	4.6%
Punojnë vullnetar	1.2%
Vazhdojnë një praktikë të paguar	1.1%
Janë duke kërkuar një punë	9.3%
Nuk kemi të dhëna	1.3%

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur numri i studentëve që janë në vazhdim të një programi Masteri jashtë ose janë të punësuar:

Nr.	Shteti	Numri i studentëve
1.	Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USA)	3
2.	Austri	4
3.	Belgjik	43
4.	Kanada	1
5.	Republika Çeke	2
6.	Estoni	7
7.	Francë	2
8.	Gjermani	17
9.	Hungari	2
10.	Itali	13
11.	Hollandë	5
12.	Spanjë	1
13.	Mbretëri e Bashkuar	10
14.	Kosovë	1
15.	Australi	3
16.	Republika Popullore e Kinës	7
17.	Japoni	4
	Gjithsej	87

Numri i të punësuarve në bazë të programeve të studimeve:

Fakulteti/ Emërtimi i programit të studimit	Përqindja e të punësuarve
I. Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë	
1. PICD- Arkitekturë	83.0%
2. BA- Inxhinieri Ndërtimi	89.8%
3. BA- Inxhinieri Kompjuterike	95.7.6%
4. BA- Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital	79.9%

5. BA- Inxhinieri Softueri	Nuk ka të dhëna për këtë program studimi pasi është program i sapo hapur.
6. Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi	97%
7. Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi	100%
8. Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike	100%
9. Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike	98%
10. Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni	93.9%
II. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative	
1. BA- Financë-Bankë	89.3%
2. BA- Administrim Biznesi	86.7%
3. BA- Ekonomiks	91.9%
4. BA- Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik	87.7%,
5. BA-Informatikë Ekonomike	91.6%
6. BA- Financë-Bankë (Shqip)	72.8%
7. Master Profesional në Financë-Bankë	97%
8. Master i Shkencave në Financë-Bankë	100%
9. Master Profesional në Administrim Biznesi	98.2 %
10. Master i Shkencave në Administrim Biznesi	94.3%
11. Master i Shkencave në Ekonomiks	100%
III. FAKULTETI I DREJTËSISË DHE SHKENCAVE SOCIALE	
1. BA- Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	87.6.5%
2. Drejtësi (Program i integruar 5-vjeçar i Ciklit të Dytë të Studimeve)	Nuk kemi të diplomuar pasi është program i hapur rishtazi.
3. Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	91.3%

Në programin e ciklit të tretë të studimeve, Doktoratë (Ph. D) gjatë viti akademik 2019-2020 janë diplomuar 3 studentë në programet: Inxhinieri Kompjuterike, Administrim Biznesi, dhe Inxhinieri Ndërtimi që janë të punësuar në pozicionin lektor.

3. Përqindjen e suksesit në provimet e shtetit kur programi i studimit ka lidhje me një profesion të rregulluar, si edhe përqindjen e profesionistëve që kanë përfunduar këtë program studimi dhe janë licencuar.

Në përfundim të vitit akademik 2010-2011, studentët e parë janë diplomuar nga programi i studimit Bachelor (4-vjeçar) në Inxhinieri Ndërtimi, ndërkohë që studentët e parë janë diplomuar nga programi i studimit Bachelor (4-vjeçar) në Arkitekturë në fund të vitit akademik 2011-2012. Në këtë kuadër, periudha më e hershme që studentët në fjalë kanë pasur mundësi të përfundojnë një program studimi Master i Shkencave ose të barasvlefshëm që i jep mundësi për të hyrë në provimin e shtetit kanë qenë fundi i vitit akademik 2011-2012 për studentët e Inxhinierisë së Ndërtimit dhe fundi i vitit akademik 2012-2013 për studentët e Arkitekturës. Lidhur me këtë çështje, institucioni nuk disponon informacion mbi numrin e të diplomuarve që kanë kaluar provimin e shtetit apo janë licencuar për vitin akademik 2019-2020, pasi ministria përgjegjëse nuk publikon listën e personave që i nënshtrohen provimeve të marrjes së licences në profesionet e rregulluara.

4. RELACION NË LIDHJE ME PLOTËSIMIN E STANDARDEVE SHTETËRORE

A. INFORMACION MBI AKREDITIMI INSTITUCIONAL DHE SECILIN PROGRAM STUDIMI;

Në bazë të detyrimit ligjor, Universiteti “EPOKA” aplikon për akreditimin periodik institucional në ASCAL si dhe për akreditimin e programeve të studimit të cilat kërkojnë t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit të jashtëm për akreditimin e parë dhe atë periodik.

Akreditimi i fundit periodik institucional është kryer në vitin 2021 dhe Universiteti “EPOKA” mbetet në pritje të Vendimit të Bordit të Akreditimit në lidhje me vlerësimin përfundimtar mbi plotësimin e Standarteve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, të gjitha programet e të studimeve të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të ofruara nga Universiteti “EPOKA” janë të akredituara si më poshtë vijon:

Programi i Studimit	Vendim i Bordit të Akreditimit/Urdhër MAS
<i>Bachelor në Inxhinieri Ndërtimi</i>	Vendim Nr. 28, datë 12.03.2021
<i>Bachelor në Inxhinieri Kompjuterike</i>	Vendim Nr. 29, datë 12.03.2021
<i>Bachelor në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikimi Dixhital</i>	Urdhër Nr. 359, datë 25.09.2015
⁴ <i>Bachelor në Inxhinieri Softueri</i>	-
<i>Bachelor në Financë- Bankë</i>	Vendim Nr. 31, datë 12.03.2021
<i>Bachelor në Financë- Bankë (Shqip)</i>	Vendim Nr. 32, datë 12.03.2021
<i>Bachelor në Administrim Biznesi</i>	Vendim Nr. 30, datë 12.03.2021
<i>Bachelor në Ekonomiks</i>	Vendim Nr. 54, datë 20.07.2017
<i>Bachelor në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>	Vendim Nr. 33, datë 12.03.2021
<i>Bachelor në Informatikë-Ekonomike</i>	Urdhër Nr. 358, datë 25.09.2015
<i>Bachelor në Marketing Ndërkombëtar dhe Menaxhim Logjistik</i>	Urdhër Nr. 288, datë 30.05.2016
⁵ <i>Programi i integruar të studimeve të ciklit të dytë në Drejtësi</i>	-
<i>Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi:Profili Inxhinieri e Strukturave të Ndërtimit</i>	Vendim Nr.7, datë 01.02.2019
<i>Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi:Profili Menaxhim i Ndërtimeve</i>	Vendim Nr.7, datë 01.02.2019
<i>Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi:Profili Inxhinieri e Resurseve Ujore</i>	Vendim Nr. 7, datë 01.02.2019
<i>Master i Shkencave në Inxhinieri Ndërtimi:Profili Inxhinieri e Materialeve të Ndërtimit</i>	Vendim Nr.7, datë 01.02.2019
<i>Master i Shkencave në Arkitekturë</i>	Vendim Nr. 53, datë 28.09.2018

⁴ Universiteti “EPOKA” do të aplikojë për akreditimin e programit të studimeve të ciklit të parë Bachelor në Inxhinieri Softueri, të paktën një vit para diplomimit të studentëve të parë të programit në fjalë

⁵ Universiteti “EPOKA” do të aplikojë për akreditimin e programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë në Drejtësi, të paktën një vit para diplomimit të studentëve të parë të programit në fjalë

<i>Master i Shkencave në Inxhinieri Kompjuterike</i>	Vendim Nr. 52, datë 28.09.2018
<i>Master i Shkencave në Inxhinieri Elektronike dhe Komunikacioni</i>	Urdhër Nr. 435, datë 25.08.2016
<i>Master i Shkencave në Financë-Bankë</i>	Vendim Nr.58, datë 28.09.2018
<i>Master i Shkencave në Administrim Biznesi</i>	Vendim Nr. 60, datë 28.09.2018
<i>Master i Shkencave në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>	Vendim Nr. 56, datë 28.09.2018
<i>Master i Shkencave në Ekonomiks</i>	Urdhër Nr. 273, datë 24.05.2016
<i>Programi i integruar i studimeve të ciklit të dytë në Arkitekturë</i>	Vendim Nr. 54, datë 28.09.2018
<i>Master Profesional në Inxhinieri Ndërtimi</i>	Vendim Nr. 48, datë 13.07.2018
<i>Master Profesional në Inxhinieri Kompjuterike</i>	Vendim Nr. 51, datë 28.09.2018
<i>Master Profesional në Financë-Bankë</i>	Vendim Nr. 57, datë 28.09.2018
<i>Master Profesional në Administrim Biznesi</i>	Vendim Nr.59, datë 28.09.2018
<i>Master Profesional në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>	Vendim Nr. 55, datë 28.09.2018
<i>Master Profesional në Menaxhim Risku dhe Mbrojtje ndaj Zjarrit në Inxhinierinë e Ndërtimit</i>	Vendim Nr. 100, datë 01.11.2019
<i>Doktoratë në Arkitekturë</i>	Urdhër Nr. 314, datë 10.06.2016
<i>Doktoratë në Inxhinieri Ndërtimi</i>	Urdhër Nr.132, datë 24.03.2016 Vendim i BA Nr. 22, datë 19.05.2017
<i>Doktoratë në Inxhinieri Kompjuterike</i>	Vendim Nr. 555, datë 23.11.2016
<i>Doktoratë në Ekonomiks: Profili Ekonomiks</i>	Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 113/1, datë 18.02.2016 Urdhër Nr.149, datë 30.03.2016 Vendim i BA Nr. 21, datë 19.05.2017
<i>Doktoratë në Ekonomiks: Profili Financë-Bankë</i>	Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 113/1, datë 18.02.2016 Urdhër Nr.149, datë 30.03.2016 Vendim i BA Nr. 21, datë 19.05.2017
<i>Doktoratë në Administrim Biznesi</i>	Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 114/1, datë 18.02.2016 Urdhër Nr.148, datë 30.03.2016 Vendim i BA Nr. 17, datë 19.05.2017.
<i>Doktoratë në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare</i>	Vendim i Këshillit të Akreditimit Nr. 115/1, datë 18.02.2016 Urdhër Nr.150, datë 30.03.2016 Vendim i BA Nr. 23, datë 19.05.2017 Vendim i BA Nr. 23/1, datë 13.07.2018

B. PËRSHTATSHMËRIA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME MISIONIN E INSTITUCIONIT;

Siç është përmendur edhe më sipër, misioni i Universitetit “EPOKA” konsiston në të qenit një institucion mësues-kërkues inovativ dhe me ndikim, në shërbim të vlerave thelbësore njerëzore nëpërmjet prodhimit, shpërndarjes dhe zhvillimit të dijeve në nivel ndërkombëtar; rritja e individëve me ndjeshmëri shoqërore, të mirëkualifikuar, produktivë, profesionalë dhe të përgjegjshëm, me shpirt

të orientuar drejt kërkimit dhe të hapur ndaj sfidave kombëtare dhe ndërkombëtare; si dhe dhënia e kontributit në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës së shoqërisë bazuar në nevojat kombëtare dhe rajonale.

Departamentet aktuale që ofrojnë programe studimi në Universitetin EPOKA:

- **Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë** (Departamenti i Arkitekturës, Departamenti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Departamenti i Inxhinierisë Kompjuterike).
- **Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative** (Departamenti i Administrim Biznesit; Departamenti i Ekonomiksit; Departamenti i Financë-Bankës).
- **Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Sociale** (Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Departamenti i Drejtësisë, Qendra për Studime Evropiane).

Në këtë kuadër, për përcaktimin e objektivave të gjitha programet e studimit kanë si bazë misionin dhe vizionin e universitetit. Të gjithë programet e studimit të të gjitha niveleve të ofruara nga ana e universitetit synojnë të përgatisin njerëz të kualifikuar e të aftë që t'i shërbejnë sa më mirë shoqërisë dhe nevojave të saj, jo vetëm në planin kombëtar, por edhe në atë global. Me qëllim mundësimin e integritimit sa më të lehtë të të diplomuarve në tregun e punës, një rëndësi e veçantë i është kushtuar lëndëve aplikative si dhe praktikave të punës, qoftë si pjesë e aktiviteteve kurrikulare, ashtu edhe atyre jashtëkurrikulare.

C. REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NGA ANA PËRMBAJTËSORE

Programet e studimit të Universitetit “EPOKA” janë në përputhje me misionin dhe vizionin e Universitetit. Një nga synimet kryesore të përbashkëta të programeve është përgatitja e intelektualëve të rinj, me dije të mjaftueshme dhe të gatshëm për të kontribuar në përballimin e nevojave të shoqërisë si dhe të aftë në menaxhimin e ekonomisë së vendit, nëpërmjet një kurrikule bashkëkohore dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Fakti që mësimdhënia zhvillohet në gjuhën angleze si gjuha e vetme e procesit të mësimdhënies, ofron mundësinë e përdorimit të literaturës më të përditësuar dhe më të njohur në fushat përkatëse të studimit, si dhe siguron një akses shumë të lehtë të studentëve në burimet elektronike dhe të shtypura të informacionit.

Me qëllim që studentët të dalin të mirëpërgatitur dhe të jenë të aftë të përfaqësojnë denjësisht veten dhe Universitetin “EPOKA”, duhet që patjetër të kenë përvetësuar programin mësimor duke u diplomuar vetëm nëse kalojnë në të gjitha lëndët dhe sigurojnë një mesatare të përgjithshme 2.00 nga 4.00, e cila në notë me pikë i korrespondon 70-74, ndërsa sipas sistemit shqiptar, notës 7.

D. REALIZIMI I SYNIMEVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT NËPËRMJET MBULIMIT ME PERSONELIN AKADEMIK TË PËRSHTATSHËM;

Universiteti “Epoka” ka siguruar një staf të mirëkualifikuar për një mësimdhënie cilësore në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Kështu, në semestrin e vjeshtës **2020-2021** janë angazhuar në procesin mësimdhënës në Universitet **105** pedagogë, prej të cilëve **5** me titullin “Profesor Doktor”, **12** me titullin “Profesor i Asocuar”, **46** me titullin “Doktor” dhe **42** me titullin “Master”. Ndërsa në semestrin e **pranverës 2020-2021** janë angazhuar në procesin mësimdhënës në Universitet **110** pedagogë, prej të cilëve **7** me titullin “Profesor Doktor”, **15** me titullin “Profesor i Asocuar”, **45** me gradën shkencore “Doktor” dhe **43** me diplomën “Master i shkencave”. Në semestrin e **vjeshtës 2020-2021**, **77 %** e stafit akademik ishte i punësuar me kohë të plotë, ndërkohë që për semestrin e **pranverës 2020-2021**, **74 %** e stafit akademik ishte i punësuar me kohë të plotë.

Fakti që anglishtja është gjuha e vetme e mësimdhënies lehtëson edhe thithjen e stafit të huaj akademik, me tituj dhe grada shkencore, i mirëkualifikuar dhe me përvojë për mësimdhënie sipas kurrikulave bashkëkohore të Universitetit “EPOKA”.

E. VLERËSIM I PËRGJITHSHËM MBI CILËSINË E STUDENTËVE DHE VLERËSIMI I TYRE PËR SECILIN VIT STUDIMI.

MESATARET E STUDENTËVE TË CIKLIT TË PARË NE BAZË VITI DHE PROGRAMI STUDIMI					
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	VITI I PARË	VITI I DYTË	VITI TRETË₆	VITI KATËRT	VIT I PESTË
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	2.67	2.71	2.44	2.57	2.25
INXHINIERI NDËRTIMI	2.43	2.8	2.54	-	-
INXHINIERI KOMPJUTERIKE	2.68	2.58	2.29	-	-
DIND-ARKITEKTURË	2.72	2.7	2.75	2.57	2.25
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	2.65	2.77	2.18	-	-
INXHINIERI SOFTUERI	2.88	-	-	-	-
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	2.64	2.57	2.31	-	-
FINANCË-BANKË	3.0	2.68	2.47	-	-
FINANCË-BANKË (SHQIP)	2.56	2.19	2.04	-	-
ADMINISTRIM BIZNESI	2.61	2.39	1.93	-	-
EKONOMIKS	2.83	2.81	2.99	-	-
INFORMATIKË EKONOMIKE	2.77	2.92	2.53	-	-
MARKETING NDERKOMBETAR DHE MENAXHIM LOGJISTIKE	2.08	2.48	1.94	-	-
FAKULTETI I DREJTESISË DHE SHKENCAVE SOCIALE	2.71	2.94	2.54	-	-
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDERKOMBËTARE	2.68	3.22	2.01	-	-
DREJTESI	2.75	2.66	3.07	-	-
MESATARJA E PËRGJITHSHME	2.67	2.74	2.43	2.57	2.25

MESATARET E STUDENTËVE TË CIKLIT TE DYTË DHE TË TRETË NË BAZË PROGRAMI STUDIMI			
Fakulteti / Emërtimi i Programit të Studimit	CIKLI I DYTË		CIKLI I TRETË
	PM	MSC	PhD
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE INXHINIERISË	2.29	2.95	3.63
INXHINIERI KOMPJUTERIKE	2.72	3.07	3.83
INXHINIERI NDËRTIMI	1.87	2.97	3.32
ARKITEKTURË	-	2.43	3.75
INXHINIERI ELEKTRONIKE DHE KOMUNIKIMI DIXHITAL	-	3.36	-

MP- MENAXHIM RISKU DHE MBROJTJE NDAJ ZJARRIT NË INXHINIERINË E NDËRTIMIT	-	-	-
FAKULTETI I SHKENCAVE EKONOMIKE DHE ADMINISTRATIVE	2.25	3.38	3.86
FINANCË- BANKË	2.04	3.21	3.84
ADMINISTRIM BIZNESI	2.46	3.4	3.76
EKONOMIKS	-	3.53	4.0
MENAXHIM BIZNESI: PROFILI MENAXHIM ARSIMI	-	-	-
FAKULTETI I DREJTESISE DHE SHKENCAVE SOCIALE	-	2.82	3.35
SHKENCA POLITIKE DHE MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE	-	2.82	3.35
MESATARJA E PËRGJITHSHME	2.27	3.05	3.61

F. RAPORTIM I PËRGJITHSHËM TABULAR I TË DHËNAVE TË VLERËSIMIT TË STUDENTËVE NDAJ PERSONELIT AKADEMIK.

Në përfundim të çdo semestri, të gjithë pedagogët e Universitetit “EPOKA” i nënshtrohen vlerësimit nga ana e studentëve. Pyetësi përmban 14 pyetje për të cilat studentët shprehen me një interval vlerësimi nga 0 që do të thotë “nuk pajtohem”, deri në 4 që do të thotë “pajtohem plotësisht”.

Në fund të çdo semestri përkatës të vitit akademik 2020-2021, vlerësimi mesatar për të gjithë pedagogët për secilën pyetje ishte si më poshtë:

Nr.	Pyetja	Vlerësimi mesatar për semestrin I	Vlerësimi mesatar për semestrin II
1.	Përmbledhja dhe objektivat e lëndës ishin paraqitur qartë në syllabus	3.56	3.52
2.	Libri dhe/ose materialet e tjera të leximit të ndihmonin për të kuptuar temën	3.51	3.49
3.	Lënda rriti dijet dhe interesin tim mbi temën	3.48	3.44
4.	Metodat e mësimdhënies në këtë lëndë ishin të përshtatshme	3.49	3.46
5.	Pedagogu ishte përgatitur mirë për leksionet	3.58	3.53
6.	Pedagogu tregoi vëmendje për ecurinë time	3.36	3.38
7.	Pedagogu ishte i disponueshëm për të ndihmuar jashtë auditorit	3.46	3.47
8.	Pedagogu vinte në kohë në auditor	3.6	3.55
9.	Pedagogu vinte rregullisht në leksione	3.62	3.57
10.	Pedagogu përdori në mënyrë të përshtatshme materialet e lëndës në lidhje me temat	3.54	3.5
11.	Pedagogu e përdori gjuhën e mësimdhënies në mënyrë të efektshme	3.54	3.5
12.	Pedagogu e vlerësoi punën time në mënyrë të drejtë	3.5	3.46
13.	Pedagogu pati dialog efektiv me studentët gjatë leksioneve	3.5	3.47
14.	Pedagogu e përfshiu dhe motivoi klasën shumë mirë	3.45	3.42

G. RELEVANCA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME ZHVILLIMET E FUNDIT EKONOMIKE NË VEND DHE ME TREGUN E PUNËS, OSE ME ZHVILLIMET E FUNDIT KULTURORE NË FUSHAT E ARTIT.

Programet e studimit që ofrohen në Universitetin EPOKA janë në përputhje me zhvillimet aktuale në vend. Universiteti jonë përpiqet të japë kontribut në disa fusha si: ekonomi, financë, teknologji informacioni, arkitekturë, inxhinieri ndërtimi, biznes etj. Vendi jonë po shkon drejt një zhvillimi ekonomik të kënaqshëm që sjell në mënyrë direkte lidhjen midis kërkesës dhe ofertës për punë. Ky fakt na nxit të diplomojmë njerëz të aftë e kompetentë, të zotë e serioz në punë. Institucioni jonë tenton të diplomojë ekspertë ekonomie me një arsim të formuar ku të jetë e mundur t'i ofrohet biznesit shqiptar zgjidhje e duhur për konsumatorin. Sfidat e reja na shoqërojnë në fushën e inxhinierisë së ndërtimit ku inxhinierë profesionistë luajnë rol tepër të rëndësishëm. Në ambjentet e saj Universiteti EPOKA posedon laboratorë të fushës së ndërtimit ku shume matje e eksperimente të suksesshme marrin jetë. Universiteti është i pajisur me disa studio arkitekture ku arkitektët e rinj, zhvillojnë projektet nën mbikqyrjen e udhëheqësve të lëndës. Gjithashtu, institucioni është i pajisur me laborator elektronike dhe laboratorë kompjuterash me parametra modernë dhe programet më të fundit. Universiteti EPOKA, ka qenë dhe do të jetë gjithmonë në relevancë të plotë me zhvillimin e teknologjisë. Tashmë, mendojmë se studentët tanë me leksionet e duhura dhe me sallat e përshtatshme për secilën fushë përkatëse, janë të aftë të përshtaten mjaft mire me kushtet e punës.

INFORMACION MBI SHËRBBIMIN NDAJ KOMUNITETIT OSE NDËRVEPRIMIN E INSTITUCIONIT ME PUBLIKUN

Një nga tre elementet kryesore në kuadër të të cilave Universiteti “EPOKA” operon, është edhe kontributi ndaj shoqërisë.

Në kuadër të planifikimit të karrierës dhe bashkëpunimit që ka me Drejtoritë Arsimore, Universiteti “EPOKA” ka ftuar grupe të ndryshme maturanësh pas orarit të mësimit në mjediset e saj për të informuar më me detaje maturanët në lidhje me profesione të ndryshme në prag të diplomimit të tyre. Në të njëjtën kohë, u ka dhënë mundësinë maturanëve të testonin nivelin e tyre në gjuhën Angleze duke qënë se prej vitesh provimi i gjuhës Angleze ka qënë i detyrueshëm në provimet e maturës shtetërore.

Gjithashtu, në kuadër të një planifikimi karriere më të mirë ka bërë të mundur takimin e tyre me pedagogë të ndryshëm për marrjen e një informacioni më të detajuar për çdo program që universiteti ynë ofron. Ndryshe nga vitet e tjera këtë vit për shkak edhe të pandemisë Covid 19 në këto seminare kanë marrë pjesë një numër më i ulët maturanësh krahasuar me vitet e shkuara. Gjatë periudhës së pandemisë Zyra e Pranimeve ka ofruar sesion informimi online për maturanët e interesuar. Edhe këtë vit Universiteti “EPOKA” ka qënë pjesë i një sërë panairesh të organizuara nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë në qytete të ndryshme ku si qëllim ka patur një informim sa më të mirë për të gjithë maturanët në vendin tonë.

Duke patur prioritet rregjistrimin e studentëve me rezultate të larta, Universiteti “EPOKA” vlerëson meritat e secilit prej studentëve përmes bursave si mëposhtë:

Bursa për maturantët të cilët kanë rezultatet si më poshtë:

- 6600 pikë apo më shumë » 100% bursë
- 6400 – 6599.99 pikë » 75% bursë
- 6200 – 6399.99 pikë » 50% bursë

Bursat bazuar në rezultatet e Provimit SAT

- 1300 pikë apo më shumë » 100% bursë
- 1290 - 1349 pikë » 75% bursë
- 1220 - 1289 pikë » 50% bursë

Për vitin e ri akademik universiteti ka vendosur dhënien e bursave të plota për disa kategori të ndryshme. Vlen të përmenden bursat që do të jepen për fëmijët e ish-policëve të rënë në krye të detyrës, fëmijëve jetimë, fëmijëve nga komuniteti Romë dhe Egjiptian si dhe gjithashtu sportistëve të dalluar.

Gjithashtu, për programet Master ka disa kategori bursash ku kriter është nota mesatare e studimeve e cila është si më poshtë.

Studentët e diplomuar në Universitetin EPOKA:

CGPA 2.70-2.99- 10% ulje
CGPA 3.00-3.29-20% ulje
CGPA 3.30-3.49- 30% ulje
CGPA 3.50-3.99- 40% ulje
CGPA 4.00 ose i pari i programit tw stidimit- 50% ulje.

Studentët e diplomuar në Universitete të tjera:

Nota mesatare 8.50-8.99- 10% ulje
Nota mesatare 9.00-9.49-20% ulje
Nota mesatare 9.50-9.99- 30% ulje
Nota mesatare 10.00- 40% ulje

Klubet Studentore

Klubet Studentore të Universitetit “EPOKA”, në përputhje me rregulloren mbi klubet studentore, si dhe falë mjedisit të universitetit, synojnë zhvillimin e studentëve jo vetëm në aspektin akademik, por edhe atë social, kulturor, intelektual dhe sportiv, si një faktor i rëndësishëm i bashkëjetesës dhe një nxitje në promovimin e vlerave humane tek të rinjtë.

Këto klube janë ngritur dhe drejtohen nga studentët e universitetit nën mbikqyrjen e një këshilluesi që mund të jetë pjesë e stafit akademik ose administrativ. Gjatë aktiviteteve të klubit, secili student zbulon cilësitë e tij dominante që e bëjnë të ndryshëm nga të tjerët, i kushtohet shumë rëndësi bashkëpunimit, aftësive menaxhuese dhe komunikimit, duke ofruar kështu një mundësi praktike për të përfutuar aftësi që nuk mund të merren në orë teorike dhe duke formuar një produkt të plotësuar të gatshëm për tregun e punës.

Në Universitetin “EPOKA” zhvillojnë veprimtarinë e tyre një numër i madh i klubeve studentore që plotësojnë interesin e të gjithë studentëve të cilat janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emri i Klubit
1.	Klubi i Akademikëve (Academics Club)
2.	Klubi i Artit dhe Kulturës (Art and Culture Club)
3.	Klubi i Inxhinierëve të Ardhshëm (Future Engineers Club)
4.	Klubi i Financës (Finance Club)
5.	Klubi i Lidërsipit të Grave (Woman Leadership Club)
6.	Klubi i Programimit (Programming Club)
7.	Klubi i Shoqërisë Sensitive (Sensitive Society)
8.	Klubi i Inovatorëve (Innovators Club)
9.	Klubi Marketing Zone (Marketing zone Club)
10.	Klubi Sporteve (Sports Club)
11.	Klubi Outdoors (Outdoors Club)
12.	Klubi Rrjeti i Ekonomistëve të Rinj (Young Economists Club)
13.	Klubi i Elektronikës (Electronics Club)
14.	Klubi n'cep (N'cep club)
15.	Klubi Cookie Rookie (Cookie Rookie Club)
16.	Klubi Kthim në të ardhmen (Back to the Future Club)
17.	Klubi i të drejtave të njeriut (Human Defenders Club)
18.	Klubi i ndihmës së parë (First Aid Club)
19.	Klubi i Studentëve Zhvillues (Developers Club)
20.	Klubi i Robotikës (Robotics ClubShqipëtr)
21.	Klubi i Multimedia-s (Multimedia Club)
22.	Dega Studentore IEEE (IEEE Student Branch Club)
23.	Klubi i zgjidhjes së konflikteve (Conflict Resolution Club)
24.	Klubi i Marëdhënieve Ndërkombëtare (International Relations Club)

Gjatë vitit akademik 2020-2021, klubet studentore pavarësisht situatës së vështirë për shkak të pandemisë kanë ndërmarrë një sërë aktiviteteve në shërbim të komunitetit të paraqitura si mëposhtë:

1. Universiteti Epoka organizoi "Clubs Fest ". Në këtë eveniment shumë të rëndësishëm për studentët, morën pjesë shumë klube me përvojë disa vjeçare dhe klube të tjera që u hapën këtë vit. Studentët u angazhuan në organizimin e këtij manifestimi, në të cilin për herë të parë morën pjesë shumë studentë. Pjesë e këtij eventi ishin edhe nxënësit e talentuar në muzikë duke interpretuar hitet më

të mira në listat botërore. Kjo ishte një festë për të gjithë ata që dëshironin të merrnin një mundësi të shkëlqyer për t'u angazhuar me diçka më të mirë dhe pozitive.

2. Klubi i Sporteve ka marrë pjesë në kampionation FSHSU në sportet: minifutboli dhe volejball. Studentët e universitetit “EPOKA” shfaqën dëshirë të madhe për të luajtur dhe vlera si : fair-play, respekt, mirëkuptim, bashkëpunim.
3. Çdo vit në ambjentet e Universitetit “EPOKA”, Dekanati i Studentëve, organizon “Spring Fest” që u jep mundësinë studentëve të shijojnë një ditë të veçantë me shumë aktivitete. Këtë vit për shkak të kushteve të vështira të pandemisë, studentët e universitetit “EPOKA” në bashkëpunim me dekanatin e studentëve organizuan E-fest, një version i traditës Spring Fest, por tërësisht online. Këtë vit pati performanca të regjistruara nga studentët dhe të diplomuar të universitetit “EPOKA”. Ky edicion përmbajti intervista me personazhe të famshëm shqiptar, pyetësor muzikore dhe shumë performanca të tjera.
4. Dekanati i Studentëve në Universitetin “EPOKA” në bashkëpunim me përgjegjësin e aktiviteteve ka organizuar aktivitete sportive dhe lojëra të ndryshme në javën e aktiviteteve.
5. Klubi Sensitive Society në 1 Qershor në ditën e fëmijëve, zhvilloi një aktivitet kushtuar fëmijëve jetimë nën ndjeshmërinë “Nuk mund të bëjmë gjëra të mëdha, vetëm gjëra të vogla me dashuri të madhe” – Nënë Tereza. Aktiviteti u mbajt në Kampusin Epoka dhe konsistoi në aktivitetet e mëposhtme:

Argëtim jashtë me muzikë dhe kërcim
Lojëra dhe aktivitete të ndryshme
Dorëzimi i dhuratave dhe pakove ushqimore të përgatitura nga donacionet e grumbulluara
6. Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia dhe nevoja e shumë njerëzve për nevoja ushqimore dhe financiare, Sensitive Society në bashkëpunim me bashkinë e Tiranës organizoi fushatën e donacionit për familjet të cilat ishin prekur shumë financiarisht nga situata e pandemisë. Studentët e universitetit “EPOKA”, dhe në kohë pandemie ishin të gatshëm të ndihmonin familjet në nevojë.
7. Klubi i lidërshiptit të grave ka organizuar forumin e hapur me gazetaren e njohur zj. Sonila Meço me temën roli i gruas në media duke diskutuar mbi problematikat dhe ndikimin që kanë gratë në media.
8. Klubi i Studentëve Zhvillues në universitetin “EPOKA” organizuan një takim online me z. Geri Cupi i nominuar në Forbes 30 under 30 për të folur mbi idetë e tij inovatore në tregëti.
9. Klubi i Artit dhe Kultures organizoi Ditën e Librit, ku studentët u mblodhën dhe ndanë me njëri-tjetrit librat që kishin lexuar.

10. Klubi i Ekonomistëve të Rinj organizoi një ceremoni çmimesh për konkursin e bursave që organizuan studentët ku i ftuar special ishte z. Artan Gjergji CEO i Bursës dhe Letrave me vlerë duke shpërndarë dhe çmimet për fituesit.

Gjatë vitit akademik 2020-2021, në Universitetin “EPOKA” janë zhvilluar Forumet e Hapura si më poshtë:

Forumet e Hapura, Viti Akademik 2020-2021			
Nr	I Ftuar	Tema	Data
1.	Geri Cupi	Si të zhvillojmë ide inovatore ne tregëti si kandidat i Forbes 30 nën 30	25.03.2021
2.	Sonila Meco	Roli i gruas në media	04.06.2021
3.	Artur Zheji	Shqipëria në 360	11.06.2021

Panairi i Karrierës

Panairi i Karrierës u organizua për të tetin vit radhazi në Universitetin “EPOKA”, Panairin e 8-të të Karrierës - Edicioni Online. Duke marrë parasysh situatën në të cilën u ndodh dhe nuk ishte mundësia për një takim ballë për ballë si çdo vit tjetër, panairi i karrierës u zhvillua në internet në platformën Livestream dhe më pas çdo kompani ishte e ndarë në dhoma specifike në platformën “Google Meet”. Qëllimi i këtij aktiviteti, i cili është bërë traditë në Universitetin tonë, është afrimi i studentëve dhe i të diplomuarve me tregun e punës. Në Panairin e Karrierës morën pjesë 55 kompani kombëtare dhe ndërkombëtare që zhvilluan diskutime në grupe me studentë dhe më pas me secilën prej tyre personalisht të cilat i dhanë mundësi 200 studentëve të universitetit të intervistoheshin për vende vakante pune si edhe intervista për programet e internshipit.

Panairi i Karrierës kishte rezultate të menjëherëshme ku si rezultat i tij një pjesë e madhe e studentëve përfituan praktika profesionale 1-2 mujore pranë kompanive në bazë të profilit të tyre. Numri i personave të cilat fituan kontratën e punës nga ky event u rrit në ditët në vijim pasi kaluan fazat e intervistimit.

H. INFORMACION NË FORMË TABELARE MBI BASHKËPUNIMET NDËRINSTITUCIONALE DHE PROJEKTET KU MERR PJESË INSTITUCIONI, KU PARAQITEN TË DHËNA MBI INSTITUCIONIN BASHKËPUNUES/PROJEKTIN (ADRESË, EMËR), DATËN DHE FORMËN E FORMALIZIMIT TË BASHKËPUNIMIT/PROJEKTIT (KONTRATË, MEMORANDUM BASHKËPUNIMI ETJ.), SEKTORIN E BASHKËPUNIMIT (MËSIMDHËNIE, KËRKIM SHKENCOR, ETJ.), DETYRAT E PALËVE DHE PRODUKTET, REZULTATET APO PËRFITIMET QË PRITEN NGA KY BASHKËPUNIM.

Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Universitetit “EPOKA” dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor është si më poshtë:

Nr.	Universiteti	Shteti	Hyrja në fuqi	Përfundimi i afatit	Forma e bashkëpunimit	Fusha e bashkëpunimit
1.	Universiteti i Kalifornisë në Pensilvani	SHBA	12.06.2015	12.06.2021	Memorandum Bashkëpunimi	-Bashkëpunim në programet e doktoratës -Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
2.	Universiteti Amerikan i Bullgarisë	Bullgari	02.02.2013	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
3.	Universiteti Amerikan në Emiratet e Bashkuara Arabe	E.B.A	27.07.2009	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
4.	Universiteti Shtetëror Baku	Azerbaj xhan	31.10.2011	31.10.2021	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
5.	Universiteti Ndërkombëtar i Ballkanit	Maqedoni	22.10.2009	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore

6.	Universiteti Ndërkombëtar Burch	Bosnje- Hercego vinë	23.05.2013	23.05.2023	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
7.	Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”	Shqipëri	-	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
8.	Universiteti i Europës Juglindore Lumina	Rumani	21.10.2011	21.10.2021	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
9.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara	Gjermani	10.05.2012	Rinohet automatikisht çdo katër vite	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
10.	Universiteti i Cassino dhe Lazio Jugore	Itali	12.06.2019	11.06.2024	Memorandum Bashkëpunimi	Bashkëpunim mbi bazë Fakulteti Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
11.	Universiteti i Nishit	Serbi	28.01.2017	27.01.2022	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
12.	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Shqipëri	12.12.2016	11.12.2021	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
13.	Universiteti Marin Barleti	Shqipëri	08.10.2016	07.10.2021	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktiviteteve shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore

14.	Universiteti Benedictine	SHBA	12.01.2016	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
15.	erg - echole de recherche graphique ecole superieure des arts	Belgjikë	22.01.2019	21.01.2024	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
16.	Kolegji Georgian i Arteve të Aplikuara dhe Teknologjisë	Kanada	03.10.2018	02.10.2020	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
17.	Universiteti Tomas Bata në Zlin	Republika Çeke	07.02.2019	06.02.2022	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
18.	Universiteti i Napolit "Federico II"	Itali	15.11.2019	14.11.2024	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
19.	Universiteti i Kampanjas "Luigi Vanvitelli"	Itali	19.07.2019	18.07.2024	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
20.	Universiteti SHR Heidelberg	Gjermania	-	Pa afat	Marrëveshje Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
21.	Instituti Kombëtar për Kërkime Ekonomike	Romania	08.04.2021	07.04.2026	Marrëveshje Bashkëpunimi Shkencor	Bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
22.	Universiteti i Tennessee në Chattanooga	USA	21.07.2021	20.07.2026	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh

						shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
23.	Universiteti i Floridas Qëndrore	USA	10.2021	10.2024	Marrëveshje e përgjithshme Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
24.	Universiteti i Teknologjisë i Dresden	Gjermani	-	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
25.	Universiteti Ndërkombëtar TISHK	Irak	-	Pa afat	Memorandum Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore
26.	Universiteti i Salentos	Itali	-	Pa afat	Marrëveshje Ndërkombëtare e Bashkëpunimi	Shkëmbim stafi dhe studentësh, bashkë-organizim aktivitetesh shkencore, pjesëmarrje në projekte të përbashkëta kërkimore

Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit mes Universitetit “EPOKA” dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në kuadrin e programit “Erasmus +” është si më poshtë:

Nr.	Institucioni	Shteti
1.	Universiteti i Ekonomikut dhe Shkencave Humane në Varshavë	Poloni
2.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani
3.	Universiteti Politeknik i Barit	Itali
4.	Universiteti i Salernos	Itali
5.	Universiteti i Teknologjisë i Gdansk	Poloni
6.	Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare në Romë	Itali
7.	Universiteti i Oradeas	Rumani
8.	Universiteti i Cassino dhe Lazio Jugore	Itali
9.	Universiteti i Lodz	Poloni

10.	Universiteti i Europës Qëndrore	Hungari
11.	Universiteti i Piteshtit	Rumani
12.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Tarnow	Poloni
13.	Universiteti i Lille	Francë
14.	Universiteti Politeknik i Bukureshtit	Rumani
15.	Universiteti i Debrecen	Hungari
16.	Universiteti “Charles”	Republika Çeke
17.	Universiteti European i Flensburg	Gjermani
18.	Universiteti i Napolit “Federico II”	Itali
19.	Universiteti i Beira Interior	Portugali
20.	Universiteti i Montpellier	Francë
21.	Universiteti Teknik i Iasi “Gheorghe Asachi”	Rumani
22.	Universiteti i Warmia dhe Mazury në Olsztyn	Poloni
23.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Bjelovar	Kroaci

Programet e shkëmbimit të studentëve

Gjatë vitit akademik 2020-2021, studentët kanë përfituar një ose dy semestra nga programet e shkëmbimit në kuadër të zbatimit të marrëveshjeve dypalëshe dhe marrëveshjeve të Programit Erasmus+.

Nr.	Emër	Mbiemër	Departamenti	Uni. Pritës	Shteti	Viti Akademik	Semestri	Metoda
1.	Astela	Veis	Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	Universiteti i Flensburgut	Gjermani	2020-2021	I	Erasmus+
2.	Deivi	Hysa	MSc në Administrim Biznesi	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2020-2021	I-II	Erasmus+
3.	Alba	Hasimja	MSc në Administrim Biznesi	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2020-2021	I-II	Erasmus+
4.	Bora	Boraj	MSc në Financë-Bankë	Universiteti i Shkencave të	Gjermani	2020-2021	I-II	Erasmus+

				Aplikuara në Mainz				
5.	Eni	Almeta	MSc në Administrim Biznesi	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2020-2021	I-II	Erasmus+
6.	Qamile	Zdrava	MSc në Administrim Biznesi	Universiteti i Lilës	Francë	2020-2021	I-II	Erasmus+
7.	Elisa	Ago	Informatikë Ekonomike	Universiteti i Lilës	Francë	2020-2021	I-II	Erasmus+
8.	Skerdi	Bime	MSc në Financë-Bankë	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	Gjermani	2020-2021	I-II	Erasmus+
9.	Tea	Hodaj	MSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	Universiteti i Oradeas	Rumani	2020-2021	II	Erasmus+
10.	Kristian	Lika	MSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	Universiteti i Oradeas	Rumani	2020-2021	II	Erasmus+

Nr.	Emër	Mbiemër	Universiteti	Programi në Universitetin "EPOKA"	Semestri
1.	Celeste	Leleu	Universiteti i Lilës	Ekonomiks	I-II
2.	Andrea Noemi	Ruiz Gutierrez	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz	MSc në Administrim Biznesi	II
3.	Giulia	Lugaresi	Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare në Romë	MSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	II
4.	Giulia	De Rossi	Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare në Romë	MSc në Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	II

Programi i shkëmbimit “Erasmus +”

Erasmus + është një program arsimor i Bashkimit Evropian që synon modernizimin e sistemeve arsimore dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut të punës. Erasmus + bashkon shtatë programet arsimore të BE-së duke lehtësuar orientimin e përfituesve dhe rregullat e pjesëmarrjes.

Në bazë të marrëveshjeve në fuqi, gjatë vitit 2020-2021 Universiteti “EPOKA” priti stafin akademik si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Universiteti Dërgues	Departmenti	Metoda	Periudha e shkëmbimit
1.	Daniela Melania Mihai	Prof. Asoc. Dr.	Universiteti i Piteshtit	Ekonomiks	ERASMUS+	19.04.2021 - 23.04.2021
2.	Madalina Brutu	Prof. Asoc. Dr.	Universiteti i Piteshtit	Ekonomiks	ERASMUS+	19.04.2021 - 23.04.2021
3.	Gennaro Maione	Dr.	Universiteti i Salernos	Administrim Biznesi	ERASMUS+	01.12.2020 - 11.03.2021
4.	Maria Fedele	Ms.	Universiteti i Cassino dhe Lazio Jugore	Administrim Biznesi	ERASMUS+	17.05.2021 - 21.05.2021
5.	Enrica Iannucci	Ms.	Universiteti i Cassino dhe Lazio Jugore	Administrim Biznesi	ERASMUS+	17.05.2021 - 21.05.2021
6.	Ancuta Rotaru	Ms.	Universiteti Teknik i Iasi “Gheorghe Asachi”	Inxhinieri Ndërtimi	ERASMUS+	06.07.2021 - 11.07.2021
7.	Petru Rotaru	Mr.	Universiteti Teknik i Iasi “Gheorghe Asachi”	Inxhinieri Ndërtimi	ERASMUS+	06.07.2021 - 11.07.2021
8.	Mergim Hoti	Mr.	Universiteti i Evropës Juglindore	Inxhinieri Kompjuterike	ERASMUS+	21.06.2021 - 05.07.2021
9.	Atanas Hristov	Mr.	Universiteti UIST	Inxhinieri Kompjuterike	ERASMUS+	12.07.2021 - 23.07.2021

Në bazë të marrëveshjeve në fuqi, gjatë vitit 2020-2021 stafi akademik i Universitetit “EPOKA” pati mundësinë të vizitojë një nga institucionet si më poshtë:

Nr	Emër Mbiemër	Titulli Akademik	Universiteti Pritës	Departamenti	Metoda	Periudha e Shkëmbimit
1.	Esmir Demaj	Dr.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Mainz, Gjermani	Administrim Biznesi	ERASMUS+	29.11.2021 - 03.12.2021
2.	Erinda Imeraj	Dr.	Universiteti i Studimeve Ndërkombëtare në Romë, Itali	Ekonomiks	ERASMUS+	25.10.2021 - 29.10.2021
3.	Artan Hysa	Dr.	Universiteti Politeknik i Barit, Itali	Arkitekturë	ERASMUS+	26.07.2021 - 30.07.2021
4.	Mirela Alhasani	Dr.	Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Tarnov, Poloni	Qendra për Studime Evropiane	ERASMUS+	22.11.2021 - 26.11.2021
5.	Reina Shehi	Dr.	Universiteti i Flensburgut, Gjermani	Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	ERASMUS+	04.11.2021 - 10.11.2021
6.	Jubjana Vila	Dr.	Universiteti i Flensburgut, Gjermani	Shkenca Politike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare	ERASMUS+	04.11.2021 - 10.11.2021
7.	Tekim Peza		Universiteti i Piteshtit, Rumani	Staf Administrativ	ERASMUS+	01.03.2021 - 05.03.2021
